

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vlora Hyseni nga Kosova në Shqipëri?! Gjyli: Si u vendos në krye të SHISH - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/vlora-hyseni-nga-kosova-ne-shqiperi-gjyli-si-u-vendos-ne-krye-te-shish/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 19:13:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 19:08:19 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6fc5b21aef16eddfcd41ad6f3d0adb20b59b85c8441eff769512e8c2318edae5
TEKSTI	e1c2975a102d66109ef78fe238dc486056b4ecc4872c0628881e0c591e374ce0
PAMJA	f4a55d2222bcc5d1861c3bbcb45d3137643b014008a490b45399dab5e3b4980b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5dec3a1bfff48480c99383793f409a6fd9a571fc15b47f33373fa09154c9e3db7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	bdb0f4977024bde548b4e3b2f30b00cf48adba46ab69ac7a79901c9e1751e8c0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5dec3a1bfff48480c99383793f409a6fd9a571fc15b47f33373fa09154c9e3db7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Eric Wendt SHBA Shqipëri-Bjellorusi OKB Donald Trump

AKTUALITET | REVIEW

Vlora Hyseni nga Kosova në Shqipëri?! Gjyli: Si u vendos në krye të SHISH



26 Shtator 2026 | 21:08

Analistja dhe pedagogia Arsejda Gjyli, e ftuar në emisionin Review me Greta Topjana në Euronews Albania, ka komentuar masën e pezullimit ndaj ish-drejtoreshës së SHISH-it, Vlora Hyseni.

Gjyli theksoi se për sa kohë cenohet informacioni shtetëror, çështja kalon në një nivel të lartë të sigurisë kombëtare.

Më tej, ajo ngriti pikëpyetje të forta mbi kriteret e përzgjedhjes së Vlora Hysenit, duke kujtuar se kjo e fundit ka mbajtur më parë postin e zëvendësdrojtorehës në AKI në Kosovë, nga ku është pezulluar nga ish-presidentja Osmani dhe më pas u shkarkua nga Kryeministri Kurti.

“Dhe fakti që automatikisht qytetarët shqiptarë ndjehen të cënuar deri në këtë pikë sa i takon pjesës së informacioneve të klasifikuara, automatikisht kjo përbën një çështje të një niveli të lartë. Është një çështje në hetim, po flasim që është lëshuar një masë sigurie, jo një masë fajësie, në termat që nuk mund të dalim në një përfundim definitiv për të thënë se cilat janë akuzat e provuara të formës së prerë. Por ka dy akuza të cilat ngrihen për ish-drejtoreshën e SHISH-it: e para e lidhin atë me përkrahjen e aktorë të cilët kanë dosje dhe po hetohen në SPAK, dhe nga ana tjetër dyshim për rrjedhje të informacionit të klasifikuar.

Dhe për këtë automatikisht shkojmë tek një masë e cila pezullon atë nga detyra, pra çohet kërkesa për pezullim nga detyra dhe automatikisht ajo është pezulluar nga detyra nga Presidenti i Republikës. Pra kjo është tabloja.

Ajo që na intereson në këtë pikë është siguria kombëtare. Po a kemi shkuar vërtetë deri në këto nivele? Mbi ç’kriteret është marrë emërimi dhe mbi ç’kriteret është bërë përzgjedhja për këtë zyrtarë e cila është e një niveli kaq të lartë, dhe mbi ç’kriteret nivelet ekzekutive përzgjidhen për të qenë në ato pozicione ku janë?

Zonja ka mbajtur dhe një pozicion në Kosovë, atë të AKI-së, që është prapë një institucion shumë i lartë i informacionit, ka qenë zv. drejtorehë atje dhe është pezulluar nga ish-presidentja, zonja Osmani, dhe pastaj nga ky vendim është shkarkuar dhe pak muaj më vonë nga zoti Kurti. Kështu që jemi tek pika që mbi ç’kriteret ngrihet, dhe ajo që duam ne të kuptojmë është: mbi ç’kriteret vendosen individët të cilët mbajnë peshë publike dhe individët që mbajnë peshë ekzekutive në këto institucione drejtuese?”, u shpreh ajo.

LAJMI I FUNDIT

20:44 “Ambasadori i SHBA figurë politike”, Ceno: Trump do i ketë sytë nga Shqipëria

20:14 Ministri i Jashtëm gjerman: Ftesa e Trumpit për Putinin në G20 është një mundësi

20:03 Shqipëri-Bjellorusi, publikohet formacioni zyrtar i Kombëtares: Ja 11 lojtarët që zbresin në fushë

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN

19:38 I dënuar për vrasjen e gruas, 49-vjeçari gjendet i pajetë në burgun e Reçit

19:24 Dita e 119-të e protestës, qytetarët mblidhen para Kryeministrit

19:21 Lavrov akuza të forta në OKB: Evropa po bllokoi bisedimet e paqes me Ukrainën, Perëndimi po shkon drejt rrugës pa krye

TESTIM

LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | VENDI

I dënuar për vrasjen e gruas, 49-vjeçari gjendet i pajetë në burgun e Reçit

Një 49-vjeçar që vuante dënimin në burgun e Reçit është gjetur i pajetë në ambientet e institucionit. Viktima është identifikuar si Agron Llapushi, i dënuar...

19:38 | 26/09/2026

AKTUALITET | LAJM KRYESOR | VENDI

Dita e 119-të e protestës, qytetarët mbledhen para Kryeministrisë

Qytetarë dhe aktivistë kanë dalë këtë të shtunë në protestën e radhës e cila hyri në ditën e saj të 119-të. Si çdo pasdite, pas...

19:24 | 26/09/2026

AKTUALITET | VENDI

Përfshihet nga flakët autobusi në hyrje të Tunelit të Krrabës, digjet plotësisht (VIDEO)

Një autobus është përfshirë nga flakët dhe është djegur plotësisht në afërsi të hyrjes së Tunelit të Krrabës. Sipas raportimeve, nga zjarri autobusi është shkrumbuar,...

19:10 | 26/09/2026

TEMA	SHËRBIME	KOMPANIA
Vendi	Live	Rreth Euronews
Rajoni	Lajmi fundit	Kushtet e përdorimit
Bota	Na ndiqni	Politika e cookie
Video	Euronews Radio	Kontaktoni
	Për persona me aftësi të kufizuara	Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026